



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 69 , datë 3.2.2021

P Ë R

**MIRATIMIN E PROJEKTMARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT,
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE TIFOZËVE KUQ E ZI, PËR RINDËRTIMIN
E DY QENDRAVE SHËNDETËSORE NË BASHKITË
DURRËS DHE SHIJAK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e projekt marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Tifozëve Kuq e Zi, për rindërtimin e dy qendrave shëndetësore në bashkitë Durrës dhe Shijak, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Autorizimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin për nënshkrimin e kësaj projekt marrëveshjeje.


3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe bashkitë Durrës e Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**Në mungesë dhe me porosi
ZËVENDËSKRYEMINISTRI
ERION BRACE**


MINISTRI I SHETIT
PËR RINDËRTIMIN
ARBEN AHMETAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

Nr. ____ prot.

Tiranë, më ____ 2020

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

KËSHILLIT MINISTRAVE

DHE

“TIFOZËVE KUQ E ZI”

PËR

**PËR RINDËRTIMIN E DY QENDRAVE SHËNDETËSORE NË BASHKITË DURRËS
DHE SHIJAK**

Sot në datën . . 2021 lidhet kjo marrëveshje ndërmjet:

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe Tifozët Kuq e Zi, i përfaqësuar nga z. Ardit Saliq, mbajtës i kartës së identitetit me Nr **J00704109N**, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, referuar më poshtë si **“Donatori”**, të cilëve bashkërisht iu referohet si **“Palët”**, dhe secilit prej tyre si **“Pala”**

Duke qenë se:

- A. Në mëngjesin e datës 26 nëntor 2019 në Shqipëri u regjistrua një ndër tërmetet më të fuqishëm të dekadave të fundit, nga i cili u dëmtuan rëndë qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë. Për përballimin e situatës së krijuar nga tërmeti është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore me Vendimin nr.750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, *“Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”*, dhe me Vendimin nr.751, datë 29.11.2019, të Këshillit të Ministrave, *“Për disa shtesa në vendimin nr.750, datë 27.11.2019, është përfshirë dhe qarku Lezhë.*
- B. Ligji nr.97/2019, *“Për miratimin e aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”,* ka përcaktuar kuadrin e nevojshëm ligjor, organet përgjegjëse si dhe një sërë masash që do të mundësojnë rimëkëmbjen e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore, ku ndër të tjera ka përcaktuar mundësinë e palëve të treta të cilat nëpërmjet donacione, të kontribuojnë në funksion të përballimit të këtyre pasojave.
Me anë të Vendimit të Komisionit Shtetëror për Rindërtim Nr.72 datë 18.01.2021 është miratuar donacioni në masën prej 3 000 000 (tre milion) lekë, i mbledhur nga *“Tifozët Kuq e Zi”* për rindërtimin e dy qendrave shëndetësore në fshatin Kullë, Njësia Administrative Sukth, Bashkia Durrës dhe në fshatin Kareç, Njësia Administrative Maminas, bashkia Shijak.
- C. Në përgjigje të kërkesave për mbështetje të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, janë solidarizuar edhe shumë shoqëri tregtare, organizata të ndryshme joqeveritare, individë, vendas ose të huaj, të cilët kanë shprehur vullnetin për të ofruar donacione të natyrave të ndryshme në natyrë, në ndihmë të procesit të rindërtimit dhe të zhvillimit të zonave të reja të shpallura.
- D. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi rregullon parimet themelore për realizimin e **“Projektit”**, në funksion të procesit të rindërtimit në një nga territoret e zonave të prekura, për rindërtimin e dy qendrave shëndetësore në fshatin Kullë, Njësia Administrative Sukth, bashkia Durrës dhe në fshatin Kareç, Njësia Administrative Maminas, bashkia Shijak, në masën prej 3 000 000 (tre milion) lekë, (referuar në vijim si **“Projekti”**), sipas kushteve teknike të pranuar nga Palët dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.
- E. Ky donacion është miratuar me Vendimin e Komisionit Shtetëror për Rindërtim, Nr. 72 datë 18.01.2021

Palët, në referim të ligjit nr.97/2019, *“Për miratimin e aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”*; bien dakord, si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i marrëveshjes

- 1.1 Objekt i kësaj marrëveshje është rindërtimi i dy qendrave shëndetësore në Bashkitë Durrës dhe Shijak, sipas detajimit më poshtë:
- Rindërtimin i Qendrës Shëndetësore në fshatin Kullë, Njësia Administrative Sukth, bashkia Durrës.
 - Rindërtimin i Qendrës Shëndetësore në fshatin Kareç, Njësia Administrative Maminas, bashkia Shijak.
- 1.2 Në kuadër të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, detyrën e njësisë zbatuese për donatorin do ta kryejë shoqëria "I&L", sh.p.k., e cila do të rindërtojë dy qendrave shëndetësore dhe detyrën e njësisë zbatuese për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve për ndërtimin e dy qendrave shëndetësore do ta kryejnë, bashkitë Durrës dhe Shijak

Neni 2

Masa e Donacionit

- 2.1 Masa e donacionit sipas kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi është në vlerën 3 000 000 (tre milion) lekë.
- 2.2 Donacioni sipas kësaj marrëveshjeje do t'i nënshtrohet të gjitha parashikimeve ligjore në fuqi për përjashtimet fiskale përkatëse, në rastet e fatkeqësive natyrore, në kuadër të procesit të rindërtimit.

Neni 3

Detyrimet e palëve

- 3.1 Midis donatorit dhe bashkive Shijak e Durrës do të lidhet marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit me qëllim zbatimin e objektit të parashikuar në nenin 1, të kësaj marrëveshjeje, në përputhje kjo edhe me legjislacionin në fuqi.
- 3.2 Bashkitë Durrës dhe Shijak do t'i vendosin në dispozicion donatorit truallin në të cilin do të rindërtohen dy qendrat shëndetësore, në kuadër të zbatimit të "Projektit".
- 3.3 Projektet e zbatimit për objektin e marrëveshjes së bashkëpunimit, do të hartohen nga donatori në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, do të miratohen nga palët me konsensus të përbashkët. Kostoja e ndërtimit të dy qendrave shëndetësore dhe vlera e projektit do të llogaritet duke marrë për bazë projektet e miratuara.
- 3.4 Lejet e nevojshme për zbatimin e "Projektit" do të nxirren nga autoritetet përgjegjëse në bashkëpunimit me njësitë zbatuese.
- 3.5 Normat e projektimit dhe të zbatimit për ndërtimet do të jenë sipas standardeve të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, si dhe të konfirmuara me certifikatën CE.
- 3.6 Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve sipas parashikimeve të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe vendimit nr.354, datë 11.5.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" do të bëhet nga bashkitë Durrës dhe Shijak.

- 3.7 “Projekti” realizohet nga kontraktori shoqëria “I&L”, sh.p.k., i cili është përzgjedhur nga donatori.
- 3.8 3.8 Bashkitë Durrës dhe Shijak do të marrin përsipër të garantojnë vendosjen në dispozicion të donatorit të sheshit të ndërtimit, si dhe të gjithë dokumentacionit të nevojshëm (leje, licenca autorizime etj.) për realizimin e “Projektit”,
- 3.9 Në lidhje me parcelat, truallin ku do të kryhen punimet, dorëzimi i shesheve të ndërtimit do të bëhet nga bashkitë Durrës dhe Shijak.
- 3.10 Donatori, sipas kësaj marrëveshjeje, do të përfitojë lehtësirat fiskale në përputhje me aktin normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, dhe parashikimeve të legjislacionit fiskal në kuadër të procesit të rindërtimit.
- 3.11 Në përfundim të realizimit të projektit, donatori përgatit listën e inventarit në bashkëpunim me bashkitë Durrës dhe Shijak (në rolin e njësisë zbatuese) dhe dokumentacionin përkatës të projektit të realizuar dhe ia përcjell Këshillit të Ministrave, i cili, me vendim, i kalon objektet e reja në pronësi të Bashkisë Durrës dhe Shijak, në përputhje me aktin normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave.
- 3.12 Të gjitha procedurat (veprimet) përfundimtare të pranimit të “Projektit”, do të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi nga bashkitë Durrës dhe Shijak.

Neni 4

Njoftimet dhe komunikimet

- 4.1 Çdo njoftim që do t’i jepet një Palë dhe çdo komunikim tjetër në lidhje me këtë kontratë do të bëhet me shkrim. Çdo ndryshim i adresës i njëres palë do të duhet t’i njoftohet me shkrim palës tjetër

Neni 5

Ndryshimet

- 5.1 Çdo ndryshim i rregullimeve apo i kushteve të kësaj marrëveshjeje do të bëhet me shkrim me një amendament të kësaj marrëveshjeje, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesit ligjorë të Palëve.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 6.1 Të gjitha mosmarrëveshjet e mundshme që do të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi do të zgjidhen me bisedime mes Palëve në kuadër të vullnetit të mirë.

NENI 7

Konfidencialiteti

- 7.1 Informacionin, dokumentacionin dhe plan-projektet që Palët do të shkëmbejnë me njëra-tjetrën në lidhje me realizimin e Projektit do t’i përdorin vetëm për qëllimet e përcaktuara dhe nuk do t’i transferojnë ato tek një palë e tretë pa marrë pëlqimin me shkrim të Palës që i ka siguruar ato.

Neni 8

Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria

8.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj dhe është e vlefshme deri në realizimin e objektit.

Përfundimi i kësaj marrëveshje bashkëpunimi nuk do të ndikojë në projektet dhe aktivitetet në vazhdim ose të përfunduara.

PËR SA MË SIPËR, të nënshkruarit, kanë nënshkruar kontratën në katër (4) origjinalë.

Nënshkruar në Tiranë
më 2021

.....
MINISTRI I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN

Arben AHMETAJ

Nënshkruar në Tiranë
më 2021

.....
**DONATORI
PËR**

“TIFOZËT KUQ E ZI”

Z.Ardit SALIAJ

NR.PROT. 664/1
DATË 5.2.2021

MINISTRIT TË SHITETIT PËR RINDËRTIMIN
BASHKIVE DURRËS E SHIJAK
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

